



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-23655

Dt: 29.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit 01 Nr. 06-20027-8/1, të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 15.04.2016 si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Shoqatës së Peshkatarëve Sportiv, Rekreative “Ereniku” në Gjakovë, me dt: 29.04.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së Peshkatarëve Sportiv, Rekreativ “Ereniku” në Gjakovë, e evidentuar me nr.10-400-9019 e dt:18.02.2016, për mbulimin e shpenzimeve të ndërlidhura me aktivitetet e parapara për pjesëmarrje në garat e Kosovës në peshkim, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 250€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 200€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Shoqatës së Peshkatarëve Sportiv, Rekreativ “Ereniku” në Gjakovë, nr. nr. 1930670249031138 BKT.

A R S Y E T I M

Kërkesa e Shoqatës së Peshkatarëve Sportiv, Rekreativ “Ereniku” në Gjakovë, e evidentuar me nr. 10-400-9019 e dt:18.02.2016, e prezantuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është në përputhshmëri me rekomandimet e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të DKRA për mbulimin e shpenzimeve të ndërlidhura me aktivitetet për pjesëmarrje në garat e Kosovës në peshkim të kësaj shoqate, duke i ndarë nga kategoria e subvencioneve shumë prej 250€. Pas rekomandimit të Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe shqyrtimin e në Mbledhjen e Bordit të dt. 15.04.2016 këtë kërkesë e ka përkrahur edhe Kryetarja e Komunës duke e autorizuar Drejtorinë për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit e këtyre mjeteve financiare në vlerë prej 250€.

Në bazë të theksimeve të përshkruara më lartë, u vendos si në dispozitiv.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Flamur Xhepa, kryetar i SHPSR “Ereniku” Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

